

**AKT THEMELIMI**  
**i Shoqërisë "Mobx Telecom" Sh.p.k.**

Sot, më datë 01 / 01/2024,

-**Znj. Rigersa Disha**, shtetase shqiptare, lindur me 06.06.1987, ne Tirane, mbajtese e dokumentit te identifikimit me nr. personal I75606075B, madhore e me zotesi te plote juridike e per te vepruar;

Në përputhje me Ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar) dhe Ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, " Për regjistrimin e biznesit ", ka vendosur të themelojë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar " **Mobx Telecom** " Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

**NENI 1**

**EMËRTIMI**

Emri i Shoqërisë është "**Mobx Telecom**" Sh.p.k.

**NENI 2**

**SELIA**

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga "Komuna e Parisit", Hyrja 1, Apartamenti 7, Zona Kadastrale 8260, Numer pasurie 6/745+1-7, Tirane.

Shoqëria mund të çelë degë dhe/ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë, si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.

**NENI 3**

**KOHËZGJATJA**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asamblesë së Ortakëve.

**NENI 4**

**OBJEKTI**

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë:

- Sherbime Network, voice;
- Instalime Software;
- Sherbime Online;
- Telekomunikacion;
- Sigurimi i sherbimeve ne fushen e komunikimeve elektronike.

Shoqëria mund të kryejë gjithashtu të gjitha operacionet tregtare, mbi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, operacione financiare, industriale, që do të vlerësohen të nevojshme apo të dobishme për realizimin e objektit të shoqërisë si dhe të blejë pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërive të tjera që kanë objekt të njëjtë, të ngjashëm apo që lidhet me të vetin. Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike.



## NENI 5

### KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributi në të holla i Ortakut themelues në vlerën 500.000 Lekë (peseqind mije) Lekë dhe është i përbërë nga një kuotë.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- **Znj. Rigersa Disha**, zotëron 1 kuotë, me 100% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 500.000 Leke (peseqind mije) Lekë dhe 500.000 Leke (peseqind mije) Lekë të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

## NENI 6

### ORGANET E SHOQËRISË

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
- Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori. Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë.

**Znj. Rigersa Disha**, shtetase shqiptare, lindur 06.06.1987, në Tirane, mbajtese e dokumentit të identifikimit me nr. personal I75606075B, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, zgjidhet si Administrator për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

## NENI 7

### LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

## NENI 8

### DISPOZITA FINALE

Ky Akt Themelimi hartohet në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Përmbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortaku themelues i shoqërisë, duke autorizuar **Administratorin Znj. Rigersa Disha** për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.

ORTAKU THEMELUES

RIGERSA DISHA

